



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 28.4.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Nezir Çoçaj.

Munguan: Fatmir Limaj, Agim Aliu, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Florina Merovci-ZPRK; Florina Shala-OSBE; Lavdim Krasniqi-IGJK; Saranda Pllana-IGJK; Petrit Hyjsa-OSBE; Albana Merja-GLPS; Visar Rushiti-GAP; Flakron Sulejmani-GIZ; Drilon Asllani-Radio Dukagjini; Margarita Kadriu-Ukelli-deputete; Beadin Sylja-KosovaPress; Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova; Lumturije Deliaj-Kosova.info; Mirjeta Dibrani-UP; Zana Boshnjaku-UP; Vlera Parduzi-UP; Sylë Ahmeti-Kosova Sot; Qëndresa Jashari-KDI; Alma Tafarshiku-EULEX; Blerta Bejtullahu-EUSR/EUOffice.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2014;
3. Nisma e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Kuvendin dhe Projekt-Rregulloren e Kuvendit;

4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja Albulena Haxhiu konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2014;

Kryetarja pasi theksoi se anëtarët e Komisioni për Legjislacion janë njoftuar për punën e IGJK-së, përmes raporteve që i kanë marrë, ia dha fjalën përfaqësuesit të këtij institucioni që të paraqes raportin para Komisionit.

Lavdim Krasniqi theksoi se të gjitha programet trajnuese që zhvillohen në Institut kanë qenë aktive. Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, që përfshinë trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, kanë qenë gjithsej 111 sish. Gjithashtu, gjatë vitit paraparak janë mbajtur trajnime për fillestarë, që përfshinë gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar për herë të parë, dhe trajnime për trajnerë dhe stafin administrativ. Gjithashtu janë të përfshira edhe trajnime për kompetenca interdisiplinare, që përfshijnë fusha të ndryshme e që organizohen për prokurorë dhe gjyqtarë. Koha për mbajtjen e një trajnimi zakonisht është një deri në dy ditë. Trajnimi zakonisht është i ndarë në tri faza, ndërsa faza e parë zgjatë 5 muaj, në të cilën kandidatët ndjekin kurset së bashku, pra prokurorë dhe gjyqtarë.

Faza e dytë zgjatë tre muaj dhe ata ndahen sipas profilit të tyre për të ndjekë trajnimet e specializuara. Me mbështetje të Komisionit Evropian, Instituti është në fazën e themelimit të një biblioteke fizike dhe elektronike. Risi tjetër paraqet edhe mësimi në distancë i kandidatëve. Vlen të theksohet raporti i auditorit të përgjithshëm për vitin e kaluar, i cili nuk ka pasur asnjë vërejtje për punën e institutit. Kemi pasur 17 kontrata prokurimi gjatë tërë vitit. Ueb faqja jonë është e tillë, që ia kanë lakmi shumë institucione në rajon.

Gjithashtu jemi duke zbatuar një kornizë pune 2 vjeçare, e cila realizohet përmes një strategjie 6 mujore. Sfidë tjetër është mungesa e një autoriteti për të detyruar gjyqtarët dhe prokurorët për të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme. Kemi pas sfida sa i përket buxhetit, për shkak të shkurtimeve buxhetore, ku si pasojë e kësaj, në tetor jemi detyruar ta ndërpresim programin për trajnim.

Kryetarja Albulena Haxhiu, më pas tha se do të ishte mirë sikur në raport të përfshiheshin disa rekomandime për komisionin, në mënyrë që të adresohen sfidat për Kuvendin. Ajo gjithashtu parashtroi disa pyetje në lidhje me atë se sa ka ndikuar trajnimi i vazhdueshëm në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si zhvillohet procesi i vlerësimit për nevojën për trajnime, dhe a i përmbushin kriteret programet për trajnim dhe sa keni qenë të përfshirë në plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të pakos së drejtësisë, a ka numër të

mjaftueshëm të stafit profesional, dhe cilat kanë qenë vështirësitë në zbatimin e projekteve me donatorët.

Selviqe Halimi pyeti se a kanë vërejtur si institut se është i nevojshëm trajnimi i vazhdueshëm profesional, dhe a ka pas ndonjë bashkëpunim me KPK-në dhe KGJK-në për të arritur marrëveshje për trajnime të detyrueshme të këtyre dy kategorive.

Armend Zemaj pyeti se kush janë ata gjyqtarë dhe prokurorë që mbajnë programet e trajnimit, në cilësinë e mësimdhënësve. Ai ngriti çështjen e nevojës së mbajtjes së këtyre trajnimeve, duke theksuar se duhet të ndodhin situata të reja për t'u mbajtur trajnimi i vazhdueshëm, në të kundërtën, për gjërat që veçse i kanë mësuar në trajnim fillestar, është e panevojshme të bëhet një gjë e tillë.

Margarita Kadriu parashtoi pyetjen se çka kanë përfituar gjyqtarët dhe prokurorët nga trajnimi. Kush janë trajnuesit e tyre dhe, a i bëni vlerësim dhe njoftim me shkrim KPK-së dhe KGJK-së për rezultatin e arritur në trajnim të të trajnuarve.

Agim Ademaj theksoi se është dashur që në raport të paraqitet një vlerësim mbi të arriturat e të trajnuarve. Ai pyeti se a ka nevojë për punëtorë shtesë që instituti ka paraqitur në raport dhe theksoi se duhet të ligjërohen më shumë tema për gjyqtarët dhe prokurorët në lidhje me prokurimin.

Nezir Çoçaj pyeti se sa është buxheti për hulumtime dhe publikime dhe a është realizuar ndonjë i tillë. Kush i përcakton trajnimet, ju apo me ndonjë kërkesë të drejtuar? A keni bërë kërkesë për staf profesional që i njohin problemet e institucionit tuaj?

Lavdim Krasniqi në përgjigjet e dhëna anëtarëve të Komisionit, theksoi se është sfidë në vete gjetja dhe vlerësimi se sa përfitojnë të trajnuarit nga trajnimet që marrin. Për trajnim fillestar nuk është e vështirë, por gjendja ndryshon tek trajnimet e vazhdueshme. Në lidhje me këtë ai theksoi se rol të rëndësishëm ka sistemi si tërësi, dhe se trajnimet fillestare duhet të bëhen para emërimit të kandidatëve, dhe jo pas emërimit, ashtu si propozohet me ndryshimet ligjore.

Kur jemi te vlerësimi, Instituti nuk e ka një autoritet të tillë, dhe deri tash nuk kemi pasur ndonjë njoftim për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana e institucioneve përkatëse, dhe kjo reflektohet edhe te programet e trajnimeve, respektivisht te nevoja për trajnime dhe avancimi i tyre.

Tek mekanizmat për vlerësim më shumë si institucion bazohemi tek raportet që nxjerrin organizatat që monitorojnë punën tonë. Krasniqi theksoi se KPK-ja dhe KGJK-ja duhet të jenë më përcaktues për politikën dhe strategjitë edhe për IGJK-në. Me ligjin për Akademinë e Drejtësisë, besojmë se do të avancohet edhe puna e institutit. Ne mendojmë se trajnimi i vazhdueshëm është i nevojshëm për një numër modulesh, dhe jo për të gjitha.

Sa i përket listës së trajnuesve, ne do t'ua dërgojmë atë. Janë shumë faktorë të cilët ndikojnë në atë se sa përfitojnë trajnuesit nga ligjëratat në trajnime, andaj duhet të përcaktohen disa standarde mbi të cilat gjykohet kjo çështje. Sa i përket zyrtarëve të administratës, nevoja për shtimin e tyre vjen edhe si rezultat i raporteve të ndryshme, veçmas atij të auditorit, sipas të cilit duhet një staf më profesional sa i përket kësaj çështje, dhe janë pozita që ligji i kërkon që t'i kemi.

Sa i përket trajnimeve dhe programeve të tyre, pengesa paraqiten kur kemi të bëjmë me module të specializuara, e ku nevojiten ekspertë të fushave përkatëse.

Kur jemi te hulumtimet, ne i kemi bërë ato vetëm për fusha të specializuara të institutit, që lidhen me zhvillimin e programeve trajnuese. Tash jemi në përfundim të bibliotekës që do të përmbajë literaturë të nevojshme, që brenda institutit dhe buxheti për publikime është rreth 15 mijë euro.

Nezir Çoçaj pyeti në lidhje me atë se një student që përfundon juridikun a është i përgatitur për prokuror dhe gjyqtar, qoftë edhe pas provimit të jurisprudencës.

Lavdim Krasniqi theksoi se duke pas parasysh natyrën e punës me të cilën duhet ballafaquar, nuk mund të quhet i përgatitur profesionalisht një individ i tillë, pa kaluar edhe në trajnime të tjera praktike, që arrihet me trajnimin fillestar.

Në fund, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Të miratohet Raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2014;
- II. Kërkohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës që Komisionit t'ia përcjell listën e trajnuesve.

3. Nisma e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Kuvendin dhe Projekt-Rregulloren e Kuvendit;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti para Komisionin Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, për të bërë hartimin e këtyre dy akteve për Kuvendin. Ajo theksoi se gjatë mandatit të kaluar është punuar në këtë çështje për tri vite, por ai draft nuk ka arritur që të votohet nga deputetët e Kuvendit. Ligji për Kuvendin është kërkesë e MSA-së. Haxhiu bëri të ditur se ky diskutim po bëhet me qëllim që Komisioni t'ia delegojë kompetencën Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Gjithashtu, ajo theksoi se kemi një draftligj për Kuvendin si rrjedhojë e procesit të binjakëzimit hungarez.

Armend Zemaj si kryesues i Nënkomisionit, theksoi se janë të gatshëm të punojnë për çdo nismë legjislative që merret me këtë punë, dhe në bazë të një plan-programi të punës që po synohet, do të bëjmë ç'është e mundur që kjo legjislaturë të ketë Ligjin dhe Rregulloren për Kuvendin.

Selviqe Halimi theksoi se nuk është shkelje e kushtetutës nxjerrja e ligjit dhe e rregullores, vetëm se këto të dyja plotësojnë njëra-tjetrën.

Margarita Kadriu ngriti çështjen e të drejtës kushtetuese për deputetët e pavarur, dhe kërkoi që të rregullohet me ligj, dhe ata deputet të kenë të drejtë vote në Komisione.

Kryetarja Albulena Haxhiu konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

1. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, merr nismën që të hartojë Projektligjin për Kuvendin;
2. Ngarkohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, që ta hartojë Projektligjin dhe të njëjtin ta paraqes për shqyrtim në Komision.

5. Të ndryshme

Albulena Haxhiu, kryetare, i njoftoi anëtarët se me ftesë të kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, më 5 maj, Komisioni për Legjislacion ka një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, në lidhje me sfidat e bizneseve në raport me sistemin e drejtësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
